



Republika e Kosovës * Republic of Kosova
Komuna * Municipality
HANI I ELEZIT



Datë: 05.11.2021
09/NE/2021

KONTRATË PËR SHËRBIME

Numri i kontratës¹: 659-21-8449-2-4-7/C220; VM-21-032-247

KOMUNA HANI I ELEZIT (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njën anë; dhe

Spital Special Për Terapi Fizikale Me Rehabilitim Banja E Kllokotit SH.P.K., Kllokot, Kllokot, 810801804, (në vazhdim "Ofruesi i Shërbimeve"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për shërbimet e shënuara me postë: **Shërbime rehabilitimi për Familjet e Deshmoreve** me numër identifikues: 659-21-8449-2-4-7

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është performimi i shërbimeve në vijim nga ana e Ofruesit të Shërbimeve:

No.	Lot
1	Shërbime rehabilitimi për Familjet e Deshmoreve

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi total i shërbimeve duhet të jetë: **950,00 €**; [Nëntëqind e pesëdhjetë] Euro.

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- Marrëveshja e kontratës;
- Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- Tenderi i Ofruesit të Shërbimeve, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- Oferta financiare (Përshkrimi i Çmimeve);

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 4 Komunikimet

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Ofruesit të Shërbimeve nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

¹ Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e faturimit dhe pagesës, procedurat dhe transaksionet që lidhen me thesarin.

të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.


4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën 2 në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Ofruesin e Shërbimeve.

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Xhevdet Bushi
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	05.11.2021
Vula:	



Për Ofruesin e Shërbimeve

Emri:	Rodent Rexhepi
Pozita:	Proprjetar
Nënshkrimi:	
Data:	05.11.2021
Vula:	



KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: 659-21-8449-2-4-7/C220

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante.]

<i>Kushtet e Përgjithshme të Kontratës</i>		<i>Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK</i>
<i>Përshkrimi i nenit</i>	<i>Nr. Nenet</i>	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë SHQIPE.
Fillimi dhe Përfundimi i shërbimeve	6.1	Data e Fillimit të fillimit të Shërbimeve është 30 dite pas nënshkrimit
	6.4	Data e Përfundimit është 05.12.2021
	6.5	Vendi i kryerjes së shërbimeve është <i>[Shërbimet mjekesore në Banjen e Kllokotit për Familjet e Deshmoreve]</i>
Obligimet e Autoritetit Kontraktues	12.3	Pagesa për kryerjen e shërbimeve mjekesore (banjes) për familjet e Deshmoreve, prinderit e Deshmoreve që do të kryejnë procedurën e rehabilitimit të banjes për periudhë 10 dite për person. Pra, Çdo prinder (nene ose baba i Deshmorit), do të trajtohet 10 dite me ushqim dhe banim, me gjitha shërbimet shëndetësore të banjes që i disponon Banja e Kllokotit!
Dëmet e likuiduara	13.1	Masat konform ligjit.
Siguria e ekzekutimit	14.1	N/A.
Sigurimi që do të merret nga ofruesi i shërbimeve	15.1	N/a
Parimet e përgjithshme të pagesës	16.1	Jo me shume se 30 dite pas pranimit të fatures
Kontrolli i kualitetit	17.1	Kontrollimi do të bëhet nga Komuna dhe familjet e deshmoreve që i shfrytëzojnë shërbimet dhe për çdo mos-kryerje të shërbimit do të merren masa për përmirësim dhe në rast se nuk përmirësohen masat janë deri në shkeputje të kontratës.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	20.2	<i>Zyra e prokurimit – K.Hani i Elezit ose KRPP-Divizioni i rregullave</i>
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	21.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet <i>[Gjykata Themelore Prishtinë – Departamenti për Çështje ekonomike]</i> në pajtim me ligjin në Kosovë. ose b) kurdo që palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të <i>[specifiko organin për zgjedhjen e mosmarrëveshjes]</i> në pajtim me <i>[specifiko rregullat e arbitrazhit (rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Komisioni i Kombeve të Bashkuara mbi Ligjin e Tregtisë Ndërkombëtare, apo procedura të tjera të arbitrazhit të njohura ndërkombëtarisht)].</i>